



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 22.04.2020)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i Rregullores “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)

**10. Erjon Muharremaj**

**(anëtar)**

**11. Marçela Shehu**

**(anëtare)**

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.**
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**

### **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i Rregullores “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Mbledhja plenare e datës 22 prill 2020 fillon me prezantimin e pikave të rendit të ditës nga Kryetarja e Këshillit, zonja Naureda Llagami dhe më pas anëtarët e Këshillit njihen me një formular të cilin e ka përgatitur specialisti i EURALIUS për mënyrën e votimit, mënyrë e cila përveçse verbalisht, do të kryhet edhe nëpërmjet këtij formulari i cili do të ruhet si dokument. Procedura e votimit lihet për t’u aplikuar në momentin kur mbledhjet plenare do të realizohen nga ambientet e Këshillit.

Fillon më pas çështja e parë e rendit të ditës e cila relatohet nga zonja Naureda Llagami, në cilësinë e kryetares së Komisioni të Përkohshëm të ngritur me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020, me qëllim hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, në këtë situatë të epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19.

Zonja Llagami shprehet se Komisioni është njohur fillimisht me Udhëzuesin e miratuar nga ISHP lidhur me rekomandimet për marrjen e masave për të lehtësuar masat kufizuese për përhapjen e Covid, masa të cilat janë përshtatur për fillimin kështu të punës në institucion. Për këtë qëllim është krijuar Rregullorja “Për përcaktimin e masave për kufizimin e përhapjes së Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

## **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Merr fjalën **zoti Alban Toro** i cili shtron për diskutim dhe pyet mbi si është menduar të realizohet ajo çka shpreh neni 5/6 i kësaj rregulloreje, pra kush do të jenë personat që do të administrojnë të dhënat “6.Struktura përgjegjëse për aq sa është e mundur duhet të vendosë kamera për të vëzhguar nëse masat e përcaktuara të higjienës dhe kujdesit zbatohen me përpikëri”. Ai sugjeron që në rregullore të përmendet edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke sugjeruar që të vendoset vetëm një autoritet i vetëm për administrimin e këtyre të dhënave. Gjithashtu edhe për nenin 5/7 zoti Toro kërkon të dijë nëse është menduar ndonjë faturë financiare për realizimin e kësaj pike (“7.Struktura përgjegjëse për aq sa është e mundur duhet të përmirësojë kontrollet inxhinierike me qellim rritjen e niveleve të ventilimit dhe të përqindjes së ajrit që qarkullon në sistem si dhe pajisjen me tunelin dezinfektues në hyrje të institucionit.”). Si dhe pika tjetër mbi të cilën zoti Toro kërkon të sqarohet është neni 6/7 “7.Punonjësi është i detyruar të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19. Në rast se punonjësi ka patur apo ka kontakt të ngushtë me një person me Covid-19 duhet të qëndrojë në vetëkarantinim dhe të njoftojë menjëherë strukturën përgjegjëse e cila më pas njofton NJVKSH-në përkatëse.” Mbi këtë të fundit, zoti Toro ka mendimin që kjo i takon autoriteteve të shëndetit publik dhe jo punëdhënësit. Gjithashtu një nga sugjerimet që jep zoti Toro është vetëdeklarim nga ana e punëmarrësit nëse do të ndihej keq.

Në përgjigje të zotit Toro, **zonja Llagami** shprehet se Komisioni e ka vlerësuar për ta vendosur në rregullore në vijimësi duke qenë se është menduar që do bashkëjtohet me situatën e COVID për një kohë të gjatë dhe se kushtet aktuale të godinës ku ushtron veprimtarinë Këshilli aktualisht nuk i mundëson as përmirësimin e kamerave as të kushteve inxhinierike. Gjithashtu në lidhje me përfshirjen e ligjit për të dhënat personale në çastin kur do të aplikohet sistemi i kamerave, zonja Llagami është dakord. Ndërsa sa i përket pikës që punonjësi është i detyruar të deklarojë pranë strukturës përgjegjëse nëse ka pasur kontakt me persona të cilët rezultojnë të jenë të infektuar me Covid-19, zonja Llagami shprehet se është një pikë e marrë nga Udhëzuesi i nxjerrë për bizneset dhe i

përshtatur për institucionin dhe se anëtarët mund ta vlerësojnë nëse duhet të jetë pjesë e rregullores apo jo.

**Zoti Toro** rimerr fjalën për të thënë se në të ardhmen Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale mund të bëjë kontrole në lidhje me ruajtjen e të dhënave personale edhe në kohën e COVID. Zoti Toro sugjeron që ajo pika 5/6 të hiqet nga rregullorja, për sa kohë nuk realizohet një formë e tillë për shkak të investimeve.

**Zoti Toska** bën një ndërhyrje sa i përket çështjes së kamerave dhe kujton anëtarët që Këshilli është i pajisur me kamera në holl e në korridoret e saj dhe ato janë të mjaftueshme për të parë grumbullimet e punonjësve në ambiente të caktuara.

**Zoti Erjon Muharremaj** propozon që të riformulohet pika 6 “6.Struktura përgjegjëse, nëse është e nevojshme, mund të vendosë kamera për të vëzhguar respektimin e masave të higjienës.”

**Zonja Llagami** shprehet më tej se nëse nga ISHP do të kërkohet vendosja e kamerave edhe në ambiente që cenojnë të dhënat personale, pa diskutim që do të rishqyrtohet. Sipas zonjës Llagami, kjo dispozitë është e hapur, madje shprehet edhe sa i përket kontrollit inxhinierik që dihet sa i përket zyrave që ndodhen në zonën e poshtme të institucionit, zyra të cilat nuk kanë ajrim dhe thjesht kërkohet një përmirësim pasi infrastruktura që është nuk e lejon një gjë të tillë.

Gjithashtu edhe **zoti Medi Bici** është i mendimit që kamerat vendosen në vende publike dhe asnjëherë në vende jo publike, si për shembull tualete.

Gjithashtu edhe **zonja Brikena Ukperaj** jep një sugjerim sa i përket rregullores duke shtuar që kjo rregullore duhet të përcaktojë edhe mënyrën se si do të mbikëqyrjet zbatimi i këtyre masave, kështu që vendosja e kamerave është një mënyrë e mbikëqyrjes së zbatimit të masave dhe duhet të trajtohet veçantë nga çështja ka apo s’ka buxhet.

Gjithashtu zonja Ukperaj mbështet mendimin e zotit Toska dhe Bici që kamerat duhet të jenë të instaluara vetëm në ambiente të përbashkëta dhe jo në zyra sepse mendohet që nëpër zyra do të jenë marrë masat e duhura.

*Zonja Shehu* është dakord me çka u tha më sipër nga kolegët dhe mbase është e mendimit që të specifikohet në rregullore ambienti ku do të vendosen kamerat, pra në një ambient të përdorimit të përbashkët.

*Zonja Llagami*, në përfundim të këtyre diskutimeve, shprehet mbi shtimin në bazën ligjore të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i cili detyron automatikisht edhe për mënyrën sesi do të përdoren kamerat.

Anëtarët e Këshillit janë dakord për sugjerimin që të shtohet në bazën ligjore edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Pas diskutimeve, pyetjeve, sugjerimeve nga anëtarët e Këshillit, hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit rregullorja bashkë me sugjerimin që të shtohet në bazën ligjore edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Miratimin e Rregullores për marrjen e masave kufizuese për përhapjen e Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimin.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 22.04.2020)*

**Pika 2 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në ambientet e selisë së tij në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së covid-19”.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

*10. Erjon Muharremaj*

*(anëtar)*

*11. Marçela Shehu*

*(anëtare)*

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në ambientet e selisë së tij në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së covid-19”.

Edhe kjo çështje e rendit të ditës relatohet nga zonja Naureda Llagami, në cilësinë e kryetares së Komisioni të Përkohshëm të ngritur me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020, me qëllim hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, në këtë situatë të epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19.

Zonja Llagami relatton shkurtimisht relacionin shpjegues mbi projektvendimin “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në ambientet e selisë së tij në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së covid-19”.

Ndër të tjera zonja Llagami shprehet se nisur nga situata e krijuar nga COVID-19 Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pezulluar ushtrimin e veprimtarisë së tij, deri në një moment të dytë.

Shqetësimi që ky Komision u mundua të adresonte nëpërmjet këtij projekt-akti është jo vetëm fillimi i veprimtarisë së Këshillit por edhe detyrimet që ka Këshilli për plotësimin e vendeve vakante në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën e Posaçme apo komandimet e gjyqtarëve në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në Shkollën e Magjistraturës dhe në Ministrinë e Drejtësisë. Për të gjitha sa u thanë më sipër janë



përcaktuar edhe zgjatjet e afateve të kandidimit pasi automatikisht me pezullimin e veprimtarisë së Këshillit, janë pezulluar edhe afatet e kandidimit. Nisur nga kjo është vlerësuar shtyrja: me një javë dhe një muaj për pozicionet e shpallura për në Gjykatën e Lartë; me një javë, dy javë, tre javë, katër javë dhe pesë javë për pozicionet e shpallura për në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; me një javë për procedurën e komandimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; me një javë për procedurën e komandimit në Shkollën e Magjistraturës dhe me një javë për procedurën e komandimit në Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu propozimi parashikon edhe fillimin e menjëhershëm të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2019-2020.

Anëtarët e Këshillit për këtë çështje të rendit të ditës nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime, prandaj hidhet në votim nga Kryetarja e Këshillit propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në ambientet e selisë së tij në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së covid-19”, dhe rezultatet e votimit janë si poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: Miratimin e vendimit “Për rifillimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor në kushtet e lehtësimit të masave të marra për kufizimin e përhapjes së covid-19”, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Përkohshëm të ngritur me vendimin e Këshillit nr. 135, datë 16.04.2020, me qëllim hartimin, propozimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të një plani masash organizative dhe administrative, në këtë situatë të epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË  
LARTË GJYQËSOR**

*(Mbledhje e realizuar me video konferencë nën asistencën e specialistëve të Misionit  
EURALIUS)*

*(Mbajtur, më 22.04.2020)*

**Pika 3 e rendit të ditës me objekt:** Diskutim i çështjes lidhur me vijimin ose jo, të pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykata.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:00 dhe mbaroi në orën 14:41.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*

**RENDI I DITËS:**

3. Diskutim i çështjes lidhur me vijimin ose jo, të pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në gjykata.

Në lidhje me pikën e tretë të rendit të ditës, zonja Llagami sqaron se ka zhvilluar një takim me Ministren e Drejtësisë, Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm lidhur me masat që duhet të merren për rifillimin e aktivitetit gjyqësor. Në takim është përcjellë nga ana e Kryetares shqetësimi sa i përket përdorimit të platformës online në gjykata për zhvillimin e seancave gjyqësore online, platformë e cila duhet të jetë e licencuar nga autoriteti përgjegjës, AKSH-i. Nga ana e Ministrisë janë të gatshëm të negociojnë me AKSH-in lidhur me mundësimin e kësaj platforme. Gjithashtu gjatë takimit u diskutua edhe çështja e rishikimit të Kodeve të Procedurave për mundësimin e seancave nëpërmjet teknologjisë së internetit. Nga ana e Ministrisë u kërkua gjithashtu që Këshilli të marrë masa për ndryshime të aktit normativ nëse do jetë e mundur për rihapjen dhe funksionalitetin e gjykatave. Gjithashtu çdo iniciativë që Këshilli do të ndërmarrë, Ministria u shpreh e gatshme që t’ia përcjellë për miratim Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit.

*Zoti Erjon Muharremaj* merr fjalën për t’u shprehur mbi situatën sa i përket platformës së mundshme që mund të përdoret nga gjykatat për mundësimin e komunikimit audio-vizual dhe konfirmimi që vjen nga kompania Skajp (SKYPE) për platformën Skajp for biznes (“Skype for business”) është i pamundur që të përdoret.

Ndërsa po diskutohet nga ana e dy Misioneve që mbështesin Këshillin për mundësinë e përdorimit të platformës Sisko Uebeks (“Cisco Webex”), propozim ky i ardhur nga AKSH-i dhe që garantohet deri në datën 1 qershor. Ndërsa sa i përket përdorimit, do të kërkojë shumë kohë instalimi i kësaj platformë në gjykata dhe institucionet që komunikojnë për shkak të punës.

Sërish merr fjalën *zonja Llagami* e cila relatton projektvendimin e përgatitur për këtë qëllim në të cilin propozohet që rifillimi i veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, të jetë më datë 27.04.2020 dhe përfundimi i pezullimit të jetë më datë 24.04.2020, dhe të ngarkohen këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave për marrjen e masave për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, në përputhje dhe respektim të masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19. Nga një informacion i ardhur nga 21 gjykata të vendit, kanë marrë urdhra dhe udhëzime mbi masat që duhet të ndiqnin për kryerjen e seancave të ngutshme, duke respektuar distancimin social dhe dezinfektimin.

#### **Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen**

Merr fjalën *zoti Alban Toro* i cili shprehet kundër hapjes së gjykatave në efikasitet të plotë dhe këtu zoti Toro ngre shqetësimin e dezinfektimit të gjykatave çdo ditë, proces i cili do të kërkonte fonde të konsiderueshme. Gjithashtu një shqetësim tjetër janë edhe pjesëmarrja e palëve në gjykim, pasi mund të ketë palë të cilët duhet të vijnë nga qytete të tjera dhe do t'u duhet të përdorin transportin publik. Edhe sa i përket gjykimit, ngre shqetësimin e Gjykatës së Tiranës ku ka mangësi në salla gjykimi dhe gjykimet kryhen në zyra, ku distancimi social do të ishte i pamundur të kryhej. Zoti Toro propozon që të hapen dhomat e këshillimit në të dy shkallët si dhe çështjet me objekt marrëdhëniet e punës.

Më tej merr fjalën *zonja Brikena Ukperaj* e cila kujton aktin normativ të miratuar nga Këshilli i Ministrave i cili përcakton se seancat gjyqësore civile, administrative dhe penale janë të pezulluara si dhe përcakton se cilat seanca gjyqësore duhet të zhvillohen.

Akti normativ, sipas zonjës Ukperaj, nuk kufizon zhvillimin e punës në dhoma këshillimi apo veprime procedurale që nuk kërkojnë praninë e palëve, prandaj zonja Ukperaj është e mendimit që për gjykatën e apelit nuk ka pengesë. Ndërsa akti i Këshillit pezulloi të gjithë veprimtarinë gjyqësore në gjykata, me përjashtim të çështjeve të ngutshme, duke sjellë pengesë në veprimtarinë e dhomave të këshillimit. Zonja Ukperaj propozon që të vijohet të zbatohet akti normativ mbi veprimtarinë në gjykata duke vijuar punën dhomat e këshillimit si dhe seancat gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e të paraburgosurve, çështjet familjare, çështjet e drejtësisë penale për të mitur, etj.

Problem mbetet, sipas zonjës Ukperaj mbetet gjykata e shkallës së parë sa i përket seancave përgatitore sepse këto seanca nuk ndalohen nga akti normativ. Këto seanca në shkallë të parë janë njësoj si seancat gjyqësore, sa i përket pranisë së palëve.

**Zoti Toro** shtron edhe një pengesë tjetër atë të çështjes së nënave me fëmijë që akti normativ i ka dhënë të drejtë të qëndrojnë në shtëpi për shkak të fëmijëve dhe çështja që ngre për diskutim zoti Toro është fakti se si gjykatat do e zgjidhin mungesë të personelit.

**Zonja Ukperaj** i përgjigjet që kjo çështje i përket masave që duhet të marrë vet gjykata gjithashtu gjyqtarët duhet të kenë vullnet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin.

**Zoti Ilir Toska** merr fjalën më tej për t'u shprehur kundër vazhdimin të pezullimit të veprimtarisë së gjykatave duke qenë se situata e pandemisë mund të zgjasë. Problem do të jetë marrja e masave dhe sa efikase do të jenë ato. Ajo çka duhet bërë është inkurajimi i kryetarëve të gjykatave me qëllim zbatimin e masave për mospërhapjen e epidemisë. Nëse do të ketë problematika konkrete, atëherë do duhet të adresohen në kohë.

**Zoti Maksim Qoku** merr fjalën në vijim për të qenë edhe ai dakord me kolegët parafolës, pra për vijimin e veprimtarisë në gjykata dhe më tej propozon që pas kësaj vendimmarrjeje, të dilet edhe me një udhëzim për të unifikuar disi punën në gjykata.

**Zonja Ukperaj** e mbështet propozimin e zotit Qoku për bërjen e një udhëzimi, udhëzim i cili mund të bëhet brenda 2-3 ditëve, deri në fillimin më datë 27 të veprimtarisë gjyqësore të gjykatave. Gjithashtu zonja Ukperaj propozon edhe heqjen nga projektvendimi të datës së përfundimit të pezullimit, duke qenë se në projekt-akt shprehet rifillimi më datë 27.04.2020. Një tjetër propozim që vjen nga zonja Ukperaj është edhe sa i përket orientimit të gjykatave nëpërmjet njoftimit që veprimtarinë gjyqësore ta kenë të orientuar brenda përmbajtjes së aktit normativ. Pra zonja Ukperaj është e mendimit që mos të bëhet një udhëzim, por thjesht të njoftohen për veprimtarinë e tyre të cilën do e kryejnë brenda aktit normativ.

**Zoti Toska** merr fjalën dhe sugjeron që t'i kërkohet Ministrisë së Drejtësisë sugjerim mbi qartësimin e aktit normativ apo ndryshim të tij për gjëra që mendohet që nuk shkojnë dhe kjo të bëhet sa më shpejt.

Mbi këtë sugjerim **zonja Llagami** shprehet që të jetë kjo një nga hapat që duhet të ndjekë Komisioni më vijimësi për të parë fillimisht në çfarë shtate janë gjykatat dhe çfarë mund t'i adresojnë Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me aktin normativ, të jetë në vijim hap pas hapi.

Më pas merr fjalën zonja **Brunilda Kadi** e cila nga sa ka kuptuar deri më tani nga ajo çka tha zonja Ukperaj, duket sikur vendimi i pezullimit i Këshillit kufizon më tepër se sa akti. Ndërkohë sot Këshilli duhet të shprehet për vendimin e pezullimit i cili përfundon sot më datë 22.04 dhe sipas saj dy janë alternativat që mund të ndiqen. Njëra nga alternativat është që Këshilli mos të shprehet fare dhe automatikisht gjykatat duhet të ndjekin vetëm udhëzimet e aktit normativ për veprimtarinë e tyre. Ndërsa alternativa tjetër është marrja e një vendimi formal duke i thënë gjykatave që s'kanë më kufizime dhe të vazhdojnë të veprojnë sipas aktit normativ.

Tjetër sugjerim që zonja Kadi jep është edhe se do të ishte mirë që Këshilli të sugjerojë një ndryshim në akt për ta pasur më të qartë dhe për të lejuar më shumë veprimtari duke i futur gjykatat kështu brenda disa kornizave për të qenë më të qartë

gjyqtarët dhe publiku. Gjithashtu zonja Kadi sugjeron që edhe gjykatat duhet të kenë një rregullore mbi masat që duhet të zbatohen për mbarëvajtjen e punës dhe ndoshta një udhëzim nga Këshilli për disa situata procedurale. Propozimi që zonja Kadi bën është që ky projektvendim të deklarojë që heq pezullimin dhe t'i lerë të kuptojnë që tani kanë vetëm aktin normativ, ndërkohë të merret përgjigje nga pjesa tjetër nëse mund të ndryshohet akti normativ ose edhe ndoshta një propozim i dytë që Këshilli edhe mund të mos shprehet fare, por të behët një njoftim për të dhënë mesazhin që vendimi i pezullimit nga ana e Këshilli nuk është më dhe çdo veprimtari e gjykatës rregullohet tashmë vetëm me aktin normativ.

**Zoti Muharremaj** në vijim të diskutimeve shprehet mbi arsyen pse Komisioni propozon rifillimin e veprimtarisë më datë 27 dhe arsyeja është për t'u dhënë pak kohë gjykatave që të përgatiten për rifillimin e veprimtarisë së tyre. Nëse sot shfuqizohet vendimi i pezullimit të shërbimeve gjyqësore, do të thotë që gjykatat nesër duhet të rifillojnë punën dhe kjo është e pamundur të ndodhë, që gjykatat të marrin masat sot për nesër.

**Zonja Kadi** shprehet se nuk mund të fillojnë gjykatat automatikisht, pasi kanë aktin normativ për zbatim.

**Zonja Ukperaj** risqaron edhe një herë qëndrimin e saj dhe shprehet se propozimi i saj është që mos të shprehet Këshilli për pezullimin dhe të shprehet vetëm për rifillimin e veprimtarisë gjyqësore më datë 27 prill dhe të shtohet në vendim që kjo veprimtari do të zbatohet sipas fushës së zbatimit të aktit normativ ose mos të shprehet në vendim Këshill por tek njoftimi të thuhet që veprimtaria gjyqësore ushtrohet në përputhje me përmbajtjen dhe fushën e zbatimit të aktit normativ.

**Zoti Toro** është i mendimit që Këshilli duhet të shprehet në vendim pasi është i vetmi autoritet në këtë fushë dhe mund të jepet orientimi që çdo gjë do të veprohet sipas aktit normativ.



Më tej merr fjalën **zoti Toska** i cili është i mendimit që Këshilli duhet të shprehet për rifillimin e veprimtarisë ashtu siç u shpreh edhe për pezullimin por nuk bën sens që të shprehet Këshilli në vendimin e tij “duke respektuar aktin normativ”. Edhe sipas zotit Toska, Këshilli mund ta shprehë këtë gjë në njoftimin e tij.

Pasojat juridike nëse shprehet Këshilli apo nuk shprehet, janë të njëjta, vijon **zonja Kadi** dhe mendon që duke u shprehur me vendim për rifillimin, do të ketë konfuzion sidomos nga qytetarët.

Merr fjalën **zoti Dritan Hallunaj** i cili propozon që Këshilli të shprehet për përfundimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në datën 27.04 dhe mos të vihet fare pika e dytë “rifillimin e veprimtarisë”, pasi disa gjykata e kanë përcaktuar një protokoll. Pika dy e projektvendimit të jetë që Këshilli të ngarkojë kryetarët për marrjen e masave për rifillimin ...

**Zonja Ukperaj** merr fjalën sërish për të thënë se duke qenë se pezullimi është i lidhur me një afat, ai mbaron kur mbaron afati dhe duke thënë përfundimin e pezullimit me datë 27, Këshilli e ka zgatur edhe pak pezullimin. Prandaj zonja Ukperaj propozon që Këshilli të shprehet në vendim me rifillimin e rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore më datë 27.04.2020 ndërsa në lidhje me pikën e dytë të projektvendimit Këshilli të shprehet që në vijim, kjo veprimtari gjyqësore do të ushtrohet në përputhje me përmbajtjen dhe fushën e zbatimit të aktit normativ (datë dhe nr.) dhe pika e tretë të jetë pika ku të ngarkohen këshillat për marrjen e masave.

Edhe **zonja Marçela Shehu** në fjalën e saj shpreh dakordësinë që Këshilli duhet të shprehet për përfundimin e pezullimit apo për rifillimin e veprimtarisë gjyqësore, por zonja Shehu nuk është dakord që të përfshihet në vendim udhëzimi për zbatimin e aktit normativ. Ndërsa për pikën e parë që u propozua nga zonja Ukperaj është dakord pasi Këshilli duhet të shprehet o rifillim o përfundim të afatit të pezullimit, shoqëruar ky edhe me një njoftim.

**Zonja Kadi** merr sërish fjalën duke sqaruar që sot përfundon afati dhe juridikisht nuk ka pse Këshilli të marrë një vendim për një gjë që i mbaron afati sot. Ndërkohë, nga ana tjetër nuk mund të vendosë Këshilli vazhdimin e pezullimit me një format tjetër, prandaj propozimi i zonjës Kadi është që pika e projektvendimit të formulohet “Vazhdimin e pezullimit deri në datën 27.04.2020”, kjo pasi fjala “rifillim” krijon konfondim me aktin normativ.

Edhe **zoti Medi Bici** jep variantin e tij për shprehjen nga ana e Këshillit dhe shprehet që ndoshta do ishte mirë shprehja “Rifillimin pjesërisht të veprimtarisë...”.

Sa i përket propozimit të bërë nga zoti Hallunaj dhe zonja Kadi mbi vazhdimin e pezullimit deri më datë 27, **zoti Toska** është i mendimit që me këtë shprehje do të duket sikur Këshilli do marrë një tjetër vendim në datë 27. Sipas tij, bën sens që puna rifillon më datë 27 dhe jo përfundimi i pezullimit me datë 27, siç thotë zoti Hallunaj pasi kjo shprehje është njësoj si të thuash “zgjatje e pezullimit”. Gjithashtu zoti Toska shprehet se akti normativ nuk ka pezulluar aktivitetin e gjykatave, por ka pezulluar disa nga aktivitetet gjyqësore, ndërsa Këshilli ka pezulluar në tërësi të gjitha shërbimet gjyqësore me përjashtimin e çështjeve të ngutshme. Nëse Këshilli vendos që të rifillojë veprimtaria gjyqësore, atëherë gjyqtarët duhet të respektojnë aktin normativ, pra atje ku ka ndalesë, do duhet të mos e zhvillojë seancën gjyqësore. Në vijim zoti Toska propozon që të hiqet pika 1 dhe të procedohet me dy pikat e tjera.

Pas diskutimeve mbi formulimin e aktit nga Kryetarja e Këshillit hidhet në votim propozimi i bërë nga zonja Ukperaj ku të hiqet pika 1 e projekt-aktit dhe projekt-akti të fillojë me pikën 2 të tij, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Maksim Qoku është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord, duke u tërhequr nga propozimi i bërë prej tij më parë.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është kundër rifillimit për shkak se shkaqet që diktojnë pezullimin nuk janë zhdukur akoma.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Naureda Llagami është dakord.

Në përfundim Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi: 1. Rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë, më datë 27.04.2020. 2. Ngarkohen këshillat dhe kryetarët në detyrë të gjykatave për marrjen e masave për rifillimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore, në përputhje dhe respektim të masave për kufizimin e përhapjes së COVID-19. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pas miratimit të këtij akti, **zonja Llagami** propozon gjithashtu që njoftimi për shtyp i përpiluar nga zoti Muharremaj për veprimtarinë e gjykatave lidhur me zbatimin e aktit normativ, të qarkullohet paralelisht me vendimin dhe gjithashtu në njoftimin për shtyp të përmendet edhe një paragraf i cili të thotë: Këshilli i Lartë Gjyqësor të marrë masa për propozimin e një iniciative ligjore për hapjen e plotë të gjykatave në një të ardhme të shpejt për të dhënë kështu një imput pozitiv qytetarëve.

**Zoti Toska** propozon që zoti Muharremaj do duhet të ribëjë një draft-njoftim pasi njoftimi i përgatitur para disa javësh nuk ka të njëjtin kontekst me situatën e sotme. Më pas ky draft të qarkullojë midis anëtarëve ku secili të bëjë komentet e tij mbi njoftimin.

Me këtë çështje të rendit të ditës përfundon mbledhja e datës 22.04.2020.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**